

Mënyra e marrjes së kampionit të FEÇEVE për kërkimin e PARAZITËVE NË ZORRË

- 1) Merrni 3 kampione të feçeve të nxjerra një ditë po një ditë jo.
- 2) Merrni kampionet në çastin e nxjerrjes në një sipërfaqe të thatë e të pastër (p.sh. oturak të sëmurësh, ose fletë gazete ose karton të palosur ose qese plastike, të vëna në një kosh ose poshtë kapakut të banjës - WC).
E RËNDËSISHME: feçet nuk duhen ndotur as me urinën as me ujin e banjës.
- 3) Merrni feçet në pika të ndryshme të tërë jashtëqitjes.
- 4) Vini në një enë me tapë plastike që mund të vidhohet, e cila jepet nga laboratorit ose mund të blihet në farmaci, një copë feçe sa një arrë; në qoftë se feçet janë të paformuara ose diarre, merrni të paktën 5-10 ml material fekal.
- 5) Mbylleni hermetikisht enën e shënoni datën dhe orën e marrjes; çojeni SA MË SHPEJT QË TË JETË E MUNDUR në sportelin e pranimit të kampioneve ose në laborator (në rast nevojë ruajeni kampionin në frigorifer maksimumi deri 24 orë); në qoftë se feçet janë TË LËNGSHME kampioni duhet të mbërrijë gjithsesi në laborator brenda 30-60 minuta nga marrja

KËRKIMI AMEBA: dërgojeni me shpejtësi kampionin e feçeve në Laborator duke e mbajtur enën në banjëmari në temperaturë 37°C

NJOFTIME TË RËNDËSISHME

Ditët e mëparshme dhe gjatë marrjes evitoni pirjen e:

- ilaçeve laksative, kundër diarresë, antimikrobike
- barium, bismut, vajra minerale
- bishtajore, fruta të thata, fruta e perime me lëkurë rezistente (pjeshka, kajsi, dardha, luleshtrydhe, fiq, domate).

MD20 Rev. N° 01	REDATTO DA	APPROVATO DA
Data di emissione: 09/05/2007	Pellegrini Cristina	Caola Iole